

VENDIM
Nr. 327, datë 23.10.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR CAKTIMIN E PROKURORËVE SI
MAGJISTRATË UDHËHEQËS NË PROGRAMIN E PRAKTIKËS
PROFESIONALE DHE PËR VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL
CILËSOR TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË**

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës, në nenin 33, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, 166 dhe 189, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Grupit të Punës sipas Relacionit nr. 2601, datë 23.10.2025, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për caktimin e prokurorëve si magjistratë udhëheqës në programin e praktikës profesionale dhe për vlerësimin etik dhe profesional cilësor të kandidatëve për magjistratë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

U shpall në Tiranë, sot, më 23.10.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani

RREGULLORE
**PËR CAKTIMIN E PROKURORËVE SI MAGJISTRATË UDHËHEQËS NË
PROGRAMIN E PRAKTIKËS PROFESIONALE DHE PËR VLERËSIMIN ETIK DHE
PROFESIONAL CILËSOR TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË**

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim:

1. Garantimin e formimit fillestar cilësor të kandidatëve për magjistratë gjatë programit të praktikës profesionale;

2. Rritjen e efektivitetit dhe dobishmërisë së programit të praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë, me qëllim përgatitjen e duhur të tyre për detyrat si prokurorë të ardhshëm;

3. Përcaktimin e kriterëve, afatit, procedurës dhe rregullave të tjera për caktimin e prokurorëve si magjistratë udhëheqës në programin e praktikës profesionale dhe për vlerësimin etik dhe profesional cilësor të kandidatëve për magjistratë;

4. Ndërveprimin institucional mes Këshillit të Lartë të Prokurorisë¹ dhe Shkollës së Magjistraturës², me qëllim realizimin dhe vlerësimin e drejtë të kandidatëve për magjistratë gjatë kryerjes së programit të praktikës profesionale.

¹ Në vijim “Këshilli”.

² Në vijim “Shkolla”.

Neni 2

Rregulla të përgjithshme të praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë

1. Praktika profesionale realizohet gjatë vitit të tretë të Programit të Formimit Fillestar të Shkollës dhe zgjat 12 muaj, duke filluar më 1 korrik deri më 30 qershor të vitit pasardhës.

2. Me qëllim formimin sa më gjithëpërfshirës në veprimtaritë e zyrës së prokurorisë, praktika profesionale ndahet në 3 (tri) periudha, me nga 4 (katër) muaj secila.

3. Këshilli cakton, për çdo kandidat për magistrat, 3 (tre) prokurorë udhëheqës të ndryshëm, për çdo periudhë.

4. Praktika profesionale në zyrën e prokurorisë zhvillohet përmes ndërveprimit profesional mes kandidatët për magistratë dhe magistratit udhëheqës, me qëllim, por pa u kufizuar në:

- a) përfshirjen, sa më shumë që është e mundur, në aspekte të punës së përditshme të veprimtarisë së magistratit udhëheqës dhe aktivitete në administrimin e zyrës së prokurorisë;
- b) përfshirjen në aspektet e menaxhimit të çështjeve dhe aktivitete në menaxhimin e dosjeve;
- c) përfshirjen në shpjegime dhe diskutime për çështjet në proces;
- d) pjesëmarrjen në seanca ose në marrjet në pyetje;
- e) diskutime mbi aspekte për standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magistratëve;
- f) pjesëmarrje dhe diskutime në përgatitjen e projektakteve që lidhen me veprimtarinë e prokurorisë.

Neni 3

Detyrat e Këshillit

1. Këshilli përcakton zyrat e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ku do të kryhet praktika profesionale nga kandidatët për magistratë, bazuar në këto kritere:

- a) disponueshmërinë e magistratëve udhëheqës;
- b) plotësimin e kriterëve ligjore si magistrat udhëheqës, sipas nenit 8, të kësaj Rregulloreje;
- c) infrastrukturën e zyrës së Prokurorisë;
- d) disponueshmërinë e hapësirës dhe mjediseve të punës për kandidatët për magistratë;
- e) mundësinë për t'u njohur me zbatimin në praktikë të kuadrit të plotë ligjor në fushën e të drejtës penale (të brendshëm dhe ndërkombëtar), aspektet specifike në hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale dhe shumëllojshmërinë e tyre.

2. Për caktimin e zyrës së Prokurorisë për kryerjen e praktikës profesionale, Këshilli mban parasysh edhe kërkesat e argumentuara të kandidatëve për magistratë, që i drejtohen Këshillit. Në këtë rast, ai merr në konsideratë aspekte që lidhen me largësinë e vendbanimit, rrethanat familjare apo sociale dhe të tjera, sipas rastit, në funksion të mbarëvajtjes së ndjekjes së praktikës profesionale, pa cenuar efikasitetin e ndjekjes së praktikës profesionale dhe duke ruajtur qëllimin për garantimin e një formimi sa më të mirë profesional.

3. Gjatë këtij procesi, Këshilli siguron rotacionin e duhur dhe barazinë mes magistratëve që plotësojnë kriteret ligjore për të qenë magistrat udhëheqës.

4. Këshilli kujdeset dhe merr masa në kohë për zëvendësimin e magistratit udhëheqës në rastet e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, komandimit, si dhe në çdo rast tjetër të parashikuar me ligj.

Neni 4

Roli i magistratit udhëheqës

1. Në rolin e mentorit, magistrati udhëheqës drejton dhe mbështet kandidatin për magistrat gjatë praktikës profesionale.

2. Magjistrati udhëheqës inkurajon, këshillon, ndjek veprimtarinë dhe sjelljen etiko-profesionale dhe informon kandidatin për magistrat, duke nxjerrë në pah njohuritë teorike në kontekstin praktik të aktivitetit të prokurorisë, brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

3. Magjistrati udhëheqës luan një rol thelbësor për të siguruar që njohuritë dhe përvoja që merr kandidati për magistrat gjatë praktikës profesionale të jenë efektive dhe të përqendruara në aftësitë profesionale të kandidatit për magistrat.

4. Mentorimi i siguron kandidatit për magistrat mbështetje për zhvillimin e aftësive profesionale, inkurajon dhe nxit bashkëpunimin me trupin gjykues dhe ndihmon arritjet në praktikë dhe zhvillimin e strukturuar për secilin kandidat për magistrat.

5. Magjistrati udhëheqës siguron mbështetje, drejtim dhe këshillim, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe standardet etike e profesionale, duke gërshetuar njohuritë e marra në formimin fillestar me zbatimin e tyre në praktikë.

6. Procesi i mentorimit dhe pjesëmarrja e kandidatit për magistrat në aktivitetin profesional të magistratit udhëheqës mbështet zhvillimin individual, duke e ndihmuar të identifikojë dhe zhvillojë aftësitë për veprimtarinë e prokurorisë, si dhe të çdo nevojë tjetër për trajnim dhe zhvillim.

Neni 5

Detyrat e magistratit udhëheqës

1. Magistratët udhëheqës në program garantojnë marrjen e përvojës profesionale në fushën e të drejtës penale.

2. Roli i magistratit udhëheqës përfshin detyrat e mëposhtme:

- i. siguron informacion mbi rolin e prokurorit, sjelljen dhe rregulloret;
- ii. dëgjon, pyet dhe mbledh informacion nga kandidati për magistrat, lidhur me aftësitë e tij;
- iii. mbështet procesin e praktikës dhe zhvillimit personal;
- iv. inkurajon kandidatin për magistrat për të marrë përgjegjësitë për zhvillimin e tij individual;
- v. vëzhgon performancën e kandidatit për magistrat;
- vi. identifikon nevojat për trajnim dhe zhvillim të magistratëve dhe, kur çmon se këto nevoja mund të përmbushen shpejt, ndihmon kandidatin për magistrat të gjejë mënyrat për përmbushjen e tyre, si dhe raporton në lidhje me to, në Shkollën e Magistraturës;
- vii. siguron pjesëmarrjen e kandidatit për magistrat në hetim dhe gjykim për të paktën 10 kallëzime/procedime penale në muaj, sipas seksioneve në prokurori (3 prej të cilat të jenë në fazë gjykimi; të paktën 1 me person të arrestuar në flagrancë; jo më shumë se 3 për të cilat vendoset mosfillim), të regjistruara për vepra penale për të cilat ligji penal parashikon dënimin deri në 10 (dhjetë) vjet burgim;
- viii. mbikëqyr zbatimin e rregullave etikoprofesionale nga kandidati për magistrat dhe raporton te drejtuesi i zyrës së Prokurorisë mbi problematikat e vërejtura;
- ix. vepron me integritet, objektivitet dhe paanësi, si dhe duke u përmbajtur nga ndonjë veprim që mund të krijojë konflikt interesi sipas ligjit ose që minon pavarësinë e mentorimit të tij.

Neni 6

Detyrat e kandidatit për magistrat

1. Përpara çdo vendimarrje apo përpilimit të një akti të rëndësishëm procedural, kandidati për magistrat konsultohet me magistratin udhëheqës, dhe në çdo rast, kryen veprimet e përcaktuara nga magistrati udhëheqës.

2. Kandidati për magistrat merr pjesë në seancat gjyqësore të ndjekura nga magistrati udhëheqës, dhe për dosjet e caktuara atij merr pjesë në përpilimin e akteve të prokurorit, sipas kriterëve dhe kërkesave të ligjit procedural penal.

3. Pas përfundimit të gjyqimit dhe dhënies së vendimit, nën mbikëqyrjen e magistratit udhëheqës, kandidati për magistrat kryen veprimet administrative për arkivimin e dosjes.

4. Kandidati për magistrat mban bashkëpunim të ngushtë me magistratin udhëheqës dhe sigurohet, që çështjet profesionale që trajtohen gjatë praktikës profesionale, të mbahen konfidenciale.

Neni 7

Vlerësimi i kandidatit për magistrat

1. Çdo magistrat udhëheqës, në fund të çdo periudhe 4-mujore (katërmujore) të praktikës profesionale, vlerëson cilësitë etike dhe profesionale të kandidatit për magistrat, duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Vlerësimi bëhet përmes Formularit të Vlerësimit të miratuar nga Shkolla e Magistraturës dhe evidenton cilësitë etike dhe profesionale të kandidatit për magistrat, dhe në veçanti:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale të prokurorit;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

3. Formulari i vlerësimit etik dhe profesional, shoqëruar nga procesverbali përkatës, nënshkruhen nga magistrati udhëheqës dhe drejtuesi i zyrës së Prokurorisë.

4. Formulari i njoftohet kandidatit për magistrat, i cili brenda 5 (pesë) ditëve ka të drejtë të bëjë komente ose shpjegime shtesë.

5. Formulari i shoqëruar me komentet ose shpjegimet shtesë të kandidatit për magistrat, kur ka të tilla, i dërgohet Këshillit dhe Shkollës, brenda 20 (njëzet) ditëve nga dita e mbarimit të çdo periudhe 4-mujore (katërmujore) të praktikës profesionale.

Neni 8

Kriteret e caktimit të magistratit udhëheqës

1. Në caktimin e magistratit udhëheqës Këshilli mban parasysh kriteret e vendosura në këtë nen. Këto kriteret nevojitet të përmbushen, njëkohësisht, nga ana e magistratit udhëheqës.

2. Kriteret për caktimin si magistrat udhëheqës janë:

- a) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë si prokuror;
- b) të jetë vlerësuar në përputhje me ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të paktën “*Shumë mirë*” në vlerësimin e fundit etik dhe profesional;
- c) të ketë përfunduar me sukses trajnimin për magistrat udhëheqës në 3 (tre) vjetët e fundit, në Shkollën e Magistraturës;
- d) të mos ketë qenë subjekt i masave disiplinore;
- e) të ketë respektuar afatet ligjore për hetimin apo gjykimin e çështjeve, të paktën në vitin paraardhës, përpara se të caktohet si magistrat udhëheqës.

3. Me qëllim verifikimin e përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Këshilli siguron informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm nga institucionet përgjegjëse.

4. Magistrati udhëheqës përfiton 5 % (pesë për qind) shtesë page mbi pagën mujore bruto fillestare, për periudhën që kryen detyrën si magistrat udhëheqës.

Procedura e caktimit të magjistratëve udhëheqës

1. Çdo 3 (tre) vjet, Këshilli publikon thirrjen për aplikime për magjistratë udhëheqës që plotëson nevojat e kandidatëve për magjistratë që kryejnë praktikën profesionale në vitin e tretë të programit të Formimit Fillestar.

2. Thirrja për aplikime i drejtohet prokurorëve në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

3. Çdo prokuror që plotëson kriteret ligjore aplikon me përjashtim të drejtuesve, zëvendës drejtuesve dhe drejtuesve të seksioneve të zyrave të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe magjistratët udhëheqës që kanë shërbyer në praktikën profesionale të vitit paraardhës.

4. Aplikimi plotësohet nga prokurori brenda afatit të caktuar në thirrje dhe shoqërohet nga dokumentet e nevojshme, që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të parashikuara në nenin 8, të Rregullores.

5. Pas plotësimit të afatit që përmban thirrja, Këshilli verifikon plotësimin e kriterëve ligjore për caktimin e magjistratëve udhëheqës.

6. Shkolla, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e listës së kandidatëve që kanë aplikuar, i dërgon Këshillit listën emërore të prokurorëve që kanë kaluar me sukses trajnimin e nevojshëm për caktimin si magjistratë udhëheqës gjatë periudhës së mëparshme 3-vjeçare (trevjeçare).

7. Këshilli, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e dokumentacionit të nevojshëm, përgatit një listë të kandidatëve, duke i renditur pjesëmarrësit në raport me plotësimin e kriterëve të parashikuara në nenin 8, pika 2, nisur nga kohëzgjatja e përvojës si prokuror.

8. Pas renditjes, deri në datën 20 qershor, Këshilli merr vendim për caktimin si magjistratë udhëheqës të kandidatëve fitues, për një numër që i përgjigjet nevojave për zhvillimin e praktikës profesionale për kandidatët për magjistratë, ku specifikohen edhe periudhat përkatëse 4-mujore (katërmujore) dhe zyrat e prokurorive për kryerjen e praktikës profesionale.

9. Këshilli, me anë të shortit, brenda trupës së magjistratëve udhëheqës përzgjedh magjistratin udhëheqës për secilin kandidat për magjistrat. Shorti hidhet një herë, për të tria periudhat katërmujore të njëpasnjëshme. E njëjta procedurë e përzgjedhjes, me short, ndiqet edhe për caktimin e kandidatëve për magjistratë.

10. Këshilli i dërgon zyrtarisht Shkollës, zyrave të Prokurorisë dhe magjistratëve udhëheqës vendimin përkatës.

11. Magjistrati udhëheqës, që për çdo arsye është i pamundur të kryejë detyrën e tij, mund të zëvendësohet nga Këshilli me një magjistrat tjetër udhëheqës, në përputhje me renditjen e miratuar. Në këtë rast, cilësia si magjistrat udhëheqës zgjat deri në plotësimin e kohëzgjatjes së trupës së magjistratëve udhëheqës.

Trupa e magjistratëve udhëheqës

1. Vlefshmëria e caktimit si magjistrat udhëheqës zgjat për 3 (tre) vjet.

2. Me qëllim për të siguruar qëndrueshmërinë në plotësimin e kriterëve të parashikuara në nenin 8, pika 2, Këshilli rifreskon çdo vit listën e magjistratëve udhëheqës. Për këtë nevojitet:

a) informacion lidhur me çështjet disiplinore;

b) një përditësim nga drejtuesi i zyrës së Prokurorisë ku magjistrati udhëheqës kryen detyrën, lidhur me respektimin e afateve ligjore për hetimin apo gjykimin e çështjeve të caktuara magjistratit udhëheqës;

c) një vlerësim nga Shkolla nëse magjistrati udhëheqës e ka kryer këtë detyrë në nivelin e duhur gjatë vitit të fundit kur ai ka qenë si magjistrat udhëheqës.

3. Pasi është siguruar informacioni i mësipërm, Këshilli mund të vendosë caktimin apo shfuqizimin e caktimit si magjistrat udhëheqës të prokurorit në fjalë, varësisht sipas informacionit të marrë sipas pikës 3, të këtij neni.

4. Në rast se nga informacioni i ardhur, konstatohet se nuk plotësohen kërkesat e nenit 8, pika 2, Këshilli vendos shfuqizimin e caktimit si magjistrat udhëheqës.

Neni 11

Shfuqizimi i caktimit si magjistrat udhëheqës

1. Këshilli, pas përditësimit të kryer sipas nenit 10, nëse konstaton se rrethanat e treguara përbëjnë pengesë për aktivitetin si magjistrat udhëheqës, informon magjistratin udhëheqës lidhur me sa ka konstatuar.

2. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e informacionit, magjistrati udhëheqës ka të drejtë të paraqesë qëndrimin e tij, me shkrim në Këshill.

3. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga plotësimi i afatit të caktuar për paraqitjen e qëndrimit, Këshilli shfuqizon caktimin si magjistrat udhëheqës dhe ia komunikon menjëherë vendimin magjistratit udhëheqës dhe Shkollës.

4. Kundër këtij vendimi, magjistrati udhëheqës që i është hequr kjo e drejtë, ka të drejtë të paraqesë ankim në gjykatë, në përputhje me nenin 192, pika 1, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Neni 12

Reduktimi i punës së magjistratit udhëheqës

1. Pas caktimit, magjistrati udhëheqës të cilit i është caktuar efektivisht një kandidat për magjistrat, nuk do të marrë pjesë në hedhjen e 10-të të shortit për ndarjen e çështjeve në zyrën e prokurorisë ku ai ushtron detyrën.

2. Drejtuesi i zyrës së Prokurorisë kontrollon respektimin e rregullit të mësipërm për reduktimin e punës dhe mban parasysh këtë reduktim kur të japë vlerësimin e tij, mbi punën e magjistratit udhëheqës në këtë zyrë të Prokurorisë.

Neni 13

Leja vjetore e paguar e kandidatit për magjistrat

1. Kandidati për magjistrat, gjatë praktikës profesionale ka të drejtë të kryejë pushime vjetore të paguara me një kohëzgjatje prej 25 (njëzet e pesë) ditë pune, prej të cilave 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune gjatë muajit gusht.

2. Për të garantuar qëllimin e praktikës profesionale, periudha e lejes së paguar vjetore të kandidatit për magjistrat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, kryhet njëkohësisht me lejen vjetore të paguar të magjistratit udhëheqës.

3. Drejtuesi i zyrës së Prokurorisë jep pushimet vjetore të paguara për kandidatin për magjistrat, pasi konsultohet me magjistratin udhëheqës, i cili është përgjegjës për atë periudhë 4-mujore (katërmujore) të praktikës profesionale.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.